



**2021**

**RAPORTI  
V JETOR**

**SHOQËRIA E SIGURIMIT ALBSIG JETË SH.A.**

## **1. Informacioni Rreth Shoqërisë**

- 1.1. Shoqëria ALBSIG JETË sh.a.
- 1.2. Misioni, vizioni dhe filozofia
- 1.3. Profili i shoqërisë
- 1.4. Mesazh i Drejtorit të Përgjithshëm
- 1.5. Klasat e sigurimit të Albsig Jetë

## **2. Strategjia e biznesit e Albsig JETË sh.a.**

- 2.1. Strategjia e biznesit e Albsig JETË sha
- 2.2. Zhvillimet kryesore të aktivitetit të ALBSIG JETË
- 2.3. Albsig Jetë dhe risku i pandemisë
- 2.4. Ndryshimi i klimës dhe mjedisi
- 2.5. Shëndeti dhe plakja
- 2.6. Rezistenca sociale-ekonomike
- 2.7. Të dhënat dhe teknologjia e re
- 2.8. Kibernetika
- 2.9. Përgjegjësia e integruar

## **3. Veprimtaritë kryesore gjatë vitit 2021**

- 3.1. Albsig Jete sha informon dhe edukon tregun
- 3.2. Analiza vjetore e shoqërisë Albsig Jetë sh.a.
- 3.3. Albsig, organizon festën e funvitit

## **4. Përgjegjësia sociale e shoqërisë Albsig sh.a.**

- 4.1. Albsig JETE sha., kontribues për një mjedis të pastër, mbjellja e pemëve në Tiranë
- 4.2. Albsig Jetë në eventin ku Bukuria e vajzave shqiptare shpalos vlerat dhe bashkon trevat Albsig Jetë - sponsor i konkursit shtojzovallja dardane

## **5. Politikat e monitorimit, administrimit dhe kontrollit të riskut të shoqërisë**

- 5.1. Kuadri i Administrimit të Riskut
- 5.2. Menaxhimi i riskut, strategjia dhe politikat e menaxhimit të riskut
- 5.3. Identifikimi dhe kategorizimi i risqeve
- 5.4. Rezultatet e marrjes në sigurim për vitin 2021
- 5.5. Toleranca dhe kufijtë e riskut
- 5.6. Administrimi i kapitalit dhe Niveli i Aftësisë Pagueuse
- 5.7. Aktive në mbulim të provigjoneve teknike
- 5.8. Marzhi i Aftësisë Pagueuse
- 5.9. Mjaftueshmëria e kapitalit
- 5.10. Teste të paralajmërimit të hershëm

## **6. Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm për vitin 2021**

- 6.1. Metodologjia dhe parimet e Auditimit të Brendshëm
- 6.2. Opinioni i Auditorit të Brendshëm

## **7. Raporti i Audituesit të Pavarur**

- 7.1. Pasqyra individuale e pozicionit financiar
- 7.2. Pasqyra individuale e të ardhurave gjithëpërfshirëse
- 7.3. Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital
- 7.4. Pasqyra individuale e flukseve monetare
- 7.5. Shënimet shpjeguese të Pasqyrave financiare individuale
- 7.6. Skedulet suplementare

## **8. Objektivat e shoqërisë**

## 1. Informacioni Rreth Shoqërisë Albsig sh.a.

### 1.1. Shoqëria ALBSIG JETË sh.a.

Albsig Jetë sh.a. (tani e tutje do i referohemi si "Shoqëria") është themeluar më 2 korrik 2019 si një shoqëri sigurimi me seli në Tiranë në adresën Rruga e Barrikadave, (Pallatet 9 Katëshe) Nr.1001. Shoqëria është një shoqëri aksionare, e regjistruar sipas ligjit nr.7638, datë 19 nëntor 1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më 19 korrik 2019 me numër identifikimi L92019017V.

Shoqëria operon sipas licensës nr.13 të lëshuar nga Autoriteti Mbikëqyrjes Financiare (tani e tutje do i referohemi si "AMF"), për të ushtruar veprimtari sigurimi jete sipas rregullave të AMF-së në territorin e Republikës së Shqipërisë. Autorizimi për të ndërmarrë aktivitetet e sigurimit të jetës është marrë më datë 13 shtator 2019. Aktivitetet kryesore të biznesit përfshijnë dhënie e shërbimeve të sigurimit për sigurim jetë-vdekje, sigurim martesë-lindje, sigurim jete i lidhur me fondet e investimit, sigurim i administrimit të fondeve kolektive, sigurim shtesë.

Kapitali i Shoqërisë është 432.254 mijë Lek i ndarë në 432.254 aksione me vlerë nominale 1.000 Lek/aksion e zotëruar 100% nga Albsig sh.a.

**31 Dhjetor 2021**

	në %	Numri i aksioneve	Në lekë
Albsig sh.a	100%	432.254	432.254.000
Totali	100%	432.254	432.254.000



### MISIONI

Albsig — Jetë është shoqëri sigurimi jete e orientuar nga cilësia, rritja e gamës së produkteve dhe portofolit, ruajtja e një gjendje financiare të shëndoshë, dhe e dedikuar të përmbushë sa më mirë kërkesat e konsumatoreve për produkte të sigurimit të jetës në tregjet dhe segmentet ku operon.



### VIZIONI

Vizioni i aksionerit të shoqërisë është pozicionimi i shoqërisë si një nga shoqëritë kryesore të sigurimit të jetës në vend, e cila ofron një gamë të gjerë produktesh tradicionale dhe novatore të sigurimeve të jetës..



### FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.



### 1.3. Profili i Shoqërisë

Emri i Shoqërisë:

**ALBSIG Jetë sh.a.**

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës:

**Z. Plarent Hamzaj  
Z. Redi Ujkashi  
Z. Klodian Gjonaj**

Drejtor i Përgjithshëm:

**Z. Ervin SPAHIU**

Lokalizimi i Zyrave Qëndrore:

**Adresa: Rr. "Barrikadave", 1001",  
No. 10 - Tirana, Albania**

Data e Themelimit:

**02 / 07 / 2019**

Kapitali Themeltar:

**432,254,000 lekë**

Numri i Punonjësve:

**10**

Aktiviteti:

**Në cilësinë e siguruesit  
të (Jetës)**

Tel:

**+355 4 22 54 664**

Website:

**[www.albsig-jete.al](http://www.albsig-jete.al)**

Kontakt:

**[info@albsig-jete.al](mailto:info@albsig-jete.al)**


**Të nderuar klientë dhe bashkëpunëtorë,**

Rezistenca e botës vazhdon të testohet ende me pandeminë që ka mbështjellë gjithë rruzullin . Shoqëritë filluan të dalin nga më e keqja e pandemisë. Industria e sigurimeve mund të mbështesë shoqërinë duke riafirmuar rolin e saj si një burim i besueshëm mbrojtjeje.

Kjo mbështetje e klientit mori shumë forma. Ne i përshpejtuam pagesat për klientët e diagnostikuar me COVID-19 dhe siguroam mundësi për klientët që përpiqen të paguajnë prime, duke i ndihmuar ata të mbajnë politikat e tyre në fuqi në një kohë kritike. Ne i rritëm përpjekjet tona për shëndetin mendor dhe mirëqenien dhe u siguroam punonjësve, mbështetje për ta dhe familjen.

Ishte kënaqësi për të parë se si punonjesit e Albsig Jetë ndihmonin njëri-tjetrin, dhe ne sajë të këtij angazhimi u arritën nivelet e pritshme edhe në kohë pandemie.

**Me respekt,  
Ervin SPAHIU**



# TABELA E PËRMBAJTJES

## Lista e Tabelave

Tabela 1: Analizë sasiore të riskut valutor të shoqërisë më 31 Dhjetor 2021 dhe 2020.

Tabela 2: Aktive në mbulim të provigjoneve teknike

Tabela 3: Niveli i kërkuar i aftësisë paguese llogaritur nga Shoqëria si dhe aftësia paguese e saj

Tabela 4: Marzhi i aftësisë paguese duke përdorur metodën e kapitalit neto më 31 Dhjetor 2021

## 1.5. Klasat e Sigurimit të Albsig Jetë sh.a.

Licienca Nr 13 Datë 13.09.2019 e Shqërisë Albsig Jetë Shoqëria e Sigurimeve Albsig Jetë sha e rregjistruar në QKB me NIPT L92019070V, në mbështetje të Vendimit të Bordit të AMF-se nr. 171, date 13.09.2019, do të ushtrojë veprimtari sigurimi jetë në këto klasa sigurimi:

* Klasa 19.	Sigurimi i jetës
	19.1 sigurimin për vdekjen; 19.2 sigurimin për mbijetesë deri në një moshë të caktuar; 19.3 sigurimin për mbijetesë deri në një moshë të caktuar ose për vdekje të parakohshme;
* Klasa 20.	Sigurimi martesë - lindje
	20.1 shpenzimet që shoqërojnë martesën ose lindjen e fëmijëve; 20.2 përfundimi i kushteve të sigurimit, i cili ka lidhje me arritjen e një moshe të caktuar të fëmijës.
* Klasa 21.	Sigurimi i jetës i lidhur me sipërmarrjet e investimeve kolektive mbulon:
	21.1 sigurimin e jetës, në rastet kur pagesa e sigurimit lidhet në mënyrë të plotë apo të pjesshme me vlerën e aksioneve apo kuotave të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, ose me vlerën e aktiveve të mbajtura në një fond të brendshëm nga siguruesi.
* Klasa 22.	Anuitetet:
	22.1 sigurim jete me elemente kursimi; 22.2 sigurim jete me afat të përcaktuar; 22.3 anuitete të shtyra; 22.4 anuitete të menjëhershme.
* Klasa 23.	Sigurimi shtesë, i cili lidhet me kontratën e sigurimit të jetës, duke përfshirë një ose më shumë nga kombinimet e mëposhtme:
	23.1 vdekje si rezultat i aksidentit; 23.2 paaftësi e përhershme në punë ose aftësi e kufizuar në punë, ose një lloj i caktuar dëmtimi si rezultat i një aksidenti; 23.3 paaftësi e përhershme në punë ose aftësi e kufizuar në punë, ose një lloj i caktuar dëmtimi si rezultat i një sëmundjeje; 23.4 paaftësi e përkohshme si rezultat i një aksidenti; 23.5 paaftësi e përkohshme si rezultat i një sëmundjeje; 23.6 paaftësi për të kryer profesionin apo punën si rrjedhojë e dëmtimeve trupore; 23.7 shërbimet spitalore; 23.8 sëmundjet e pashërueshme; 23.9 shërbimet mjekësore.





**Shoqëria**  
**ALBSIG** *Jeta*

**Jeta ka të bëjë me**  
**Ekuilibrin.**



## 2. Strategjia e biznesit e Albsig JETË sha

### 2.1. Strategjia e biznesit e Albsig JETË sh.a.

Marka jonë është e njohur mirë tashmë , Albsig Jete si pjesë e Albsig sh.a. është diferencuar në treg nga ofrimi i produkteve konkurruese dhe ofertave inovative, fuqisë financiare dhe ekspertizës duke ndihmuar në nxitjen e rritjes së ardhshme dhe në rritjen e vlerës së aksionerëve.

Do të vazhdojmë të fokusohemi në strategjinë tonë, duke krijuar vlerë duke u fokusuar në tre shtyllat e mëposhtme:



**Fokusimi** — fokusohemi për të shpërndarë vlerë dhe burime në mundësitë me vlerën më të lartë monetare.

**Thjeshtësia** — Thjeshtojmë biznesin tonë për të ofruar efikasitet operacional dhe një përvojë të jashtëzakonshme të klientit.

**Diferencimi** — Nxitni avantazhin konkurrues përmes markës sonë, shkallës, talentit dhe inovacionit.

## 2.2 Zhvillimet kryesore të aktivitetit të ALBSIG JETË sh.a.

Aktiviteti i shoqërisë për vitin 2021 vlerësohet pozitiv. Bilanci i shoqërisë rezulton me fitim. Veprimtaria ekonomiko-financiare e vitit 2021 çoi në konsolidimin e mëtejshëm të shoqërisë Albsig Jetë Sh.a, që tashmë përfaqëson një subjekt të konsoliduar, konform të gjitha standarteve dhe kërkesave të akteve ligjore nënligjore.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jetës kapi shifrën 1,430,262 mijë lekë duke shënuar një rritje në masën 22.74 % krahasuar me vitin 2020.

Numri i kontratave në sigurimin e Jetës arriti në 105,646 duke shënuar një ulje në masën 17.79% krahasuar me vitin 2020.

Gjatë vitit 2021, që është viti i dytë i plotë i aktivitetit, shoqëria Albsig Jetë Sh.a., është pozicionuar në vend të katërt në tregun e sigurimeve të jetës duke zënë 12.47 % të tregut. Pavarësisht ndikimit të pandemisë shoqëria Albsig Jetë për vitin 2021 arriti objektivat e saj, duke rritur dhe konsoliduar më tej e prezencën e saj në tregun e sigurimeve të jetës , me rritje prej 100% të volumit të shitjeve dhe me një zgjerim të prezencës nga 7.65 në 12.47% të tregut.

Për vitin 2021 shoqëria Albsig Jetë ka paguar 123 kontrata me vlerë 31,820 mijë lekë ndërkohë që për vitin 2020 janë paguar 27 kontrata 6,225 mijë lekë dëme të paguara. Gjithashtu, shoqëria Albsig Jetë ka 5 dëme në statusin Dëme pezull në 31.12.2021 me një vlerë prej 16,351 mijë lekësh duke zënë 7.99% të tregut edhe për këtë tregues, duke realizuar objektivat e saj për të qenë lider në treg për trajtimin e dëmeve.

## 2.3 Albsig Jetë dhe risku i pandemisë

COVID-19 krijoi një vështirësi mbi rolin e siguruesve në humbje lidhur me pandemitë dhe gjithashtu zbuloi boshllëqe në mbulim për shoqëritë siguruese.

Ndërsa situata është ende duke u zhvilluar në Shqipëri dhe në mbarë botën ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj, Menaxhimi pret që zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë, të ndikohen nga situata.

Monitorimi i kujdesshëm mbi ndikimet e pritshme të pandemisë dhe efektet negative mbi ecurinë e aktiviteteve është në fokusin e Menaxhimit të Shoqërisë Albsig Jete sh.a.

Reagimi i hershëm në përshtatjen e procedurave të marrjes në sigurim duke saktësuar edhe mbulimin e humbjes së jetës për shkak dhe/ose të lidhur me COVID 19, ndikoi pozitivisht në përballimin me sukses të situatës së krijuar për shkak të pandemisë dhe gjithashtu në minimizimin e numrit të rasteve të humbjes së jetës të ndodhura gjatë 2020 dhe të paguara të gjitha nga ana e shoqërisë.

Monitorimi dhe përshtatja e procedurave të marrjes në sigurim në rakordim me partnerin risigurues do të vijojë me të njëjtin kujdes të shtuar edhe gjatë vitit vijues deri në qetësimin e plotë të kësaj situatës.



## 2.4. Ndryshimi i klimës dhe mjedisi

Ndryshimet klimaterike dhe mjedisi janë të rëndësishme për jetën e klientëve tanë. Jetojmë në kohë ndryshimesh në nivelin e klimës dhe të gjitha shoqërohen me derivime të risqeve prezent.

Duhet të përballemi në përgjithësi me sfidat dhe mundësitë më të ngutshme që lindin nga ndryshimet klimatike dhe rreziqet e bazuara në natyrë — nga rreziqet e klimës fizike si përmytjet në implikimet e kalimit në një ekonomi me karbon të ulët dhe erozioni i ekosistemeve natyrore — për të identifikuar rolin që mund të luajnë siguruesit dhe palët e tjera të interesuara për të ndihmuar zbutur dhe përshtatur ndaj rreziqeve urgjente të lidhura.



## 2.5 Shëndeti dhe plakja

Nevojat për shëndet dhe mirëqënie po rriten në madhësi dhe kompleksitet. Plakja e popullsisë dhe kushtet sot shëndetësore janë pranë sfidave që paraqesin sëmundjet infektive si p.sh COVID-19. Megjithatë, shumica e kujdesit shëndetësor dhe social në lidhje me të moshuarit si dhe sistemet në përgjithësi nuk janë të përgatitura mirë për të menaxhuar këto tranzicione. Siguruesit e shëndetit dhe jetës do të duhet të mendojnë se si të evoluojnë produktet e tyre dhe modelet e funksionimit për të adresuar hendekun e vërejtur midis shtrirjes së shëndetit, jetës dhe pasurisë.



Nevojat për shëndet dhe mirëqënie po rriten në madhësi dhe kompleksitet. Plakja e popullsisë dhe kushtet sot shëndetësore janë pranë sfidave që paraqesin sëmundjet infektive si p.sh COVID-19. Megjithatë, shumica e kujdesit shëndetësor dhe social në lidhje me të moshuarit si dhe sistemet në përgjithësi nuk janë të përgatitura mirë për të menaxhuar këto tranzicione. Siguruesit e shëndetit dhe jetës do të duhet të mendojnë se si të evoluojnë produktet e tyre dhe modelet e funksionimit për të adresuar hendekun e vërejtur midis shtrirjes së shëndetit, jetës dhe pasurisë.

Kështu pyetjet në këto kushte lindin natyrshëm.

**Kështu pyetjet në këto kushte lindin natyrshëm:**

**Çfarë do të duhet për të siguruar një shërim të shëndetshëm nga COVID-19?**

**Dy vjet present të COVID-19. Çfarë kemi mësuar?**

Duke bërë një bilanc të ndikimit shoqëror të pandemisë shikojmë se si pandemia ka ndryshuar qëndrimet drejt sigurimit të jetës dhe shëndetit dhe ka përkeqësuar pabarazitë ekzistuese në mbrojtjen ndaj rrezikut. Dy vitet e fundit kanë testuar individin, shoqërinë dhe elasticitetin ekonomik dhe na mësoi se kemi nevojë për mirëqënien tonë: fizike, mendore, financiare dhe më gjerësisht shoqërore.

Në një qasje si konsumatorët shikojnë industrinë e sigurimeve për të rritur mbrojtjen, shëndetin duhet gjithashtu të rimendojnë mënyrën se si të bëjmë biznes për të përballuar kompleksitetin në rritje të shëndetit dhe nevojave financiare afatgjata për të gjitha grupmoshat.

Sipas përfundimeve të konferencës , u fokusuar së pari në mësimet e nxjerra nga pandemia COVID-19 dhe së dyti mbi forcat ekzistuese të përshpejtuara nga pandemia që po riformësojnë shëndetin, mirëqënien dhe jetëgjatësinë.

Një qëndër të vëmendjes janë vaksinat —

**Si do ta riformësojnë shëndetin rreziqet?**

Fokusuar në teknologjinë e vaksinave, si dhe ndikimi i gjithë rrezikut që vjen nga sëmundjet infektive dhe mënyrën me të cilën opinioni publik duhet evoluojnë për t'u bërë më transparentë.

**Shëndeti dhe sistemet shëndetësore – Çfarë lëndoi COVID-19 më shumë?**

Mësimet e nxjerra u fokusuan në tri fusha: sëmundjet kronike, shëndetin mendor dhe kujdesin ndaj të moshuarve.

**Cfarë do të thotë e gjithë kjo për jetën dhe siguresit shëndetësor?**

Një rritje e konsultimeve shëndetësore digjitale gjatë pandemisë dhe nevojën për akses të përmirësuar në teknologji në të gjithë globin për të siguruar që këto shërbime të jenë të aksesueshme

<sup>1</sup>Konferenca e Shëndetit dhe Plakjes 2021, Gjeneve

<sup>2</sup>Konferenca e Shëndetit dhe Plakjes 2021 bashkëorganizuar me AXA

<sup>3</sup>Helen Colhoun, Universiteti i Edinburgut; Shekhar Saxena, Shkolla e Shëndetit Publik të Harvardit T. H. Chan.

<sup>4</sup>Në fund: Joan Costa-Font, LSE; Annabel Bentley (Moderatore), AXA Health

## 2.6 Rezistenca sociale-ekonomike

Tendencat kryesore po ndryshojnë fytyrën e shoqërisë sonë: pabarazia në rritje e të ardhurave dhe pasurisë, zgjerimi i ekonomisë dhe urbanizim i pandërprerë.

COVID-19 pandemia po i shtohet sfidës ashtu siç ka të ngjarë të kenë ndikime afatgjata ekonomike dhe sociale në një shkallë globale. Sipas përfundimeve, tendencat sociale ekonomike dhe ndikimi i tyre është një risk që përcakton zgjidhje për shoqëri më elastike.



## 2.7 Të dhënat dhe teknologjia e re

Teknologjia po e transformon thelbësisht modelin e biznesit në të gjitha industritë, duke përfshirë sigurimet. Të rejat dhe teknologjitë në zhvillim ndikojnë në një transformim potencial, duke u fokusuar kryesisht në mënyrën se si mund të përfitojnë klientët dhe shoqëria për sa i përket modeleve të biznesit, përvojës së klientit, ndarjes së vlerave dhe etikës.





## 2.8. Kibernetika

Qasja kibernetike eksploron kushtet për pengesa dhe për një ri/sigurim të qëndrueshëm kibernetik tregu, gjeneron njohuri mbi sfidat e trajtimi kibernetik si një risk i sigurueshëm dhe promovon kontribut të sigurimit për të zbutur atë që është një risk në rritje i shoqërisë.



## 2.9. Përgjegjësia e integruar

Ndërsa bota bëhet më komplekse dhe krijon sfida të reja globale, shtohen shqetësimet e përgjegjësisë, duke filluar nga sigurimi i ri i teknologjisë industriale dhe digjitale si dhe ndikimit të inflacionit social.

**Cilat do të jenë implikimet sot ne lidhje me përgjegjësitë e biznesit?**

Vlerësohen zhvendosjet në peizazhin e riskut të pasivitetit, me fokus të veçantë në kuptimin e tendencave në zhvillim për kufijtë e sigurimit.



## 3. Veprimtaritë kryesore gjatë vitit 2021

### 3.1 Alsig Jete sh.a. informon dhe edukon tregun

Shoqëria e Sigurimeve Alsig-Jetë, ka ndërmarrë një nismë të rëndësishme për informimin e bizneseve për produktet dhe tarifatat e tyre. Duke mbyllur vitin e dytë të aktivitetit Alsig ka hedhur në treg oferta të përshtatshme për sigurimet e jetës.

Edhe pse vit pandemik dhe i kufizuar Alsig e ka përmbyllur atë me arritje të mira në treg përsa i përket sigurimit të jetës.

Alsig Jetë, përveç bashkëpunimit me Bashkinë Tiranë, ku gjithmonë e më shumë ka shtuar bashkëpunimin dhe marrëdhënien është përfshirë gjithashtu edhe në ;

Takime me biznese të ndryshme (korporata dhe SME) për sigurimet e jetës, shëndetit dhe aksidenteve për stafin e tyre. Përfitimet e biznesit dhe individit nëse ata investojnë në këto sigurime;

Takime me bashki të ndryshme të vendit dhe institucione të tjera shtetërore për promovimin e sigurimeve të jetës dhe të shëndetit;

Takime me institucione financiare të ndryshme për zgjerimin e bashkëpunimit dhe ofrimin e sigurimeve të jetës të klientëve të tyre në mënyrë që të jenë të mbrojtur financiarisht;

### 3.2 Analiza vjetore e shoqërisë Alsig Jetë sh.a.

Puna e këtij fillimviti ka nisur me Analizën Vjetore të Shoqërisë së Sigurimeve Alsig Jetë sha .

Alsig Jetë sha me strategji të qartë kërkon për të qënë sa më e pranishme me të gjithë gamën e produkteve të sigurimeve për të cilat synojmë gjithmonë të jemi një hap përpara dhe në përmirësim të vazhdueshëm e të pandalshëm.

Në analizën e punës e cila është bërë traditë, kanë marrë pjesë drejtues dhe specialist të punësuar në Alsig duke përfshirë këtu gjithë rrjetin e shitjes dhe administrimin.

Krahas punës së të gjithë stafit gjatë vitit 2021, u vlerësua puna dhe arritjet si dhe u diskutuan dhe u morën angazhime për të vazhduar punën me përkushtim në shërbim të klientit.

U vendosën strategjitë e punës si Prioritetet, avantazhet dhe objektivat për vitin 2022.

Këto kanë qënë dhe cështjet më të përfolura për planin e punës për vitin 2022.

### 3.3 Alsig Jetë, organizon festën e fundvitit.

Kur të gjithë punojmë me profesionalizëm dhe trasmentojmë energji positive puna bëhet edhe me e mire dhe si rrjedhim shoqëria ka gjithmonë sukses.

Festa e fundvitit konkretizoi të gjithë angazhimin e punës për vitin dhe jo vetem kaq por, në saj të kësaj feste u nxorën në pah dhe u përzgjedhën punonjësit më të mirë të vitit.

Kjo përzgjedhje e bërë është përkthyer si një stimul i madh për punonjësit. Tradita është ripërtërirë ndër vite për të stimuluar sadopak punonjësit dhe për ti bërë ata të ndihen sa më mirë në ambientet ku punojnë.

Festa e këtij viti u organizua me detaje me qëllime të caktuara si: argëtues, edukativ, promovues për punonjësit e më gjerë.



## 4. Përgjegjësia sociale e shoqërisë Albsig Jete sh.a.

### 4.1 Albsig JETE sha., kontribues për një mjedis të pastër, mbjellja e pemëve në Tiranë

Zgjedhim të ecim bashkë, me vlerat që na bashkojnë, duke u bërë bashkëudhëtarë të jetës tuaj, në të gjitha drejtimet!

Albsig Jetë sha kontribuon në mbjelljen e pemëve në zonën e Liqenit Artificial, nismë kjo, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, duke kontribuar sado pak në cilësinë e shëndetit të gjithsecilit prej nesh!



Nismës së ndërmarrë i është bashkëngjitur stafi i Albsig i përfaqësuar nga dy zv./drejtorët e Përgjithshëm të Shoqërisë z. Dritan Kastrati dhe z. Plarent Hamzaj si dhe Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë Albsig Jetë z Ervin Spahiu dhe Drejtori i Përgjithshëm i Albsig Invest z. Elton Korbi. Albsig ka ndërmarrë një sërë nismash në ndihmë të komunitetit.

Prej vitesh në treg, kemi vërtetuar se jemi partneri që ecën krahas jush, për ta bërë jetën tuaj një vend më të sigurt e të qetë, përmes gamës së shërbimeve që ofrojmë.

E megjithatë, donim të shkonim përtej kësaj.

Jo vetëm jetën, pronën, njerëzit, por kishim si qëllim të bëheshim nismëtarë në sigurimin e një pjese të mushkërisë së qytetit, e si rrjedhojë edhe të shëndetit të çdo qytetari të Tiranës.



Të lumtur, që mund të bëhemi shembull që qyteti të mund të marrë frymë lirisht, pak më shumë çdo ditë.

## 4.2 Albsig Jete ne eventin ku Bukuria e vajzave shqiptare shpalos vlerat dhe bashkon trevat

### Albsig Jetë – sponsor i konkursit shtojzovallja dardane

Albsig Jetë është bërë pjesë e Sofrës Dardane, duke sponsorizuar një prej eventeve më të shumëpritura të këtij festivali traditash e arti që bashkon çdo vit shqiptarët e të gjithave trevave në Malësinë e Gjakovës; atë të Shtojzovallës Dardane; një konkurs bukurie që shpalos huret femërore shqiptare dhe që çdo vit i jep vajzave fituese një mundësi për të ndjekur ëndrrat e tyre.

Sofra Dardane është bërë prej 19 vitesh tashmë, festivali që ka kthyer Tropojën në një kryeqytet kulture gjatë tri ditëve të zhvillimit të tij. Çdo qershor, mbi njëmijë artistë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi, mblidhen në Tropojë për t'i bërë jehonë me talentin e tyre folklorit, traditave e vlerave shqiptare, duke ftuar të gjithë që t'i bashkohen kësaj sofre madhështore ku ofrohet më e mira e çdo krahine. Këngët, vallet, kostumet dhe panorama e mrekullueshme e malësisë të bëjnë të ndihesh krenar e t'i gëzohesh jetës në këto troje që kanë ditur të ruajnë identitetin ndër shekuj.

Qershori, muaji në të cilin është zgjedhur të zhvillohet festivali, nuk përkon vetëm me fillimin e sezonit veror e turistik, por ka gjithashtu kuptim të dyfishtë historik. Më 10 Qershor, 1878 u krijua Lidhja e Prizrenit që synonte mbrojtjen e integritetit dhe identitetit të shqiptarëve, e më 12 Qershor, 1999, Kosova u çlirua nga Serbia për t'u kthyer në një shtet të lirë e të pavarur. Konteksti historik i këtij muaji, shton edhe më shumë vlerat e festivalit dhe përkon më së miri edhe me vlerat e Albsig Jetë që është shoqëri e ndërtuar mbi cilësitë më të mira që karakterizojnë çdo shqiptar dhe që në çdo hap të punës së saj respekton atë që kombi ynë ka më të vyer; besimin e dhënë nga çdo klient.

Konkursi i bukurisë Shtojzovallja Dardane i dha mundësi shoqërisë Albsig Jetë të bashkëpunonte me organizatorin e festivalit Sofra Dardane Z. Adrian Progni dhe me Drejtoreshën Ekzekutive të Qendrës "Gratë në Shërbim Publik", Znj. Mimoza Hajdarmataj për të mbështetur ruajtjen e trashëgimisë kulturore, por edhe për të dhënë kontributin e saj në ndihmë të vajzave të reja shqiptare që sapo kanë nisur rrugën e jetës. Ndryshe nga një konkurs i zakonshëm bukurie, Shtojzovallja Dardane shpalos në radhë të parë vlerat e gruas shqiptare në të gjitha trevat dhe është një çast bashkimi kulturor e shpirtëror i tre shteteve që historinë e kanë ndarë së bashku. Imazhi i shtojzovallëve shqiptare nuk është aspak ai i mediave sociale, por reflekton etnografinë dhe historinë në të gjitha ngjyrimet e tyre dhe me simbolikë domethënëse.



Gjakova ishte qyteti ku u zhvillua këtë vit kjo veprimtari për të zgjeruar edhe më tej aktivitetet kulturore të Sofrës Dardane. Ky qytet, mbledhi vajzat më të bukura nga Tropoja, Gjakova, Deçani, Peja, Plava dhe Gucia, vende këto, në një shtrirje gjeografike përreth zemrës së Alpeve Shqiptare, të cilat u krenuan me bukurinë e shtojzovallëve që me hijeshinë e tyre sollën në vëmendje kostumet tradicionale dhe pamjet magjepsëse të çdo treve. Shtojzovallja Dardane do të udhëtojë vit pas viti në secilën nga krahinat pjesëmarrëse për t'u kthyer edhe në një traditë bashkëpunimi mes komunave.

Ngjyrat, muzika, vallet dhe pjesëmarrja mbresëlënëse në këtë festival traditash, të bënë të kuptosh sa shumë e ka dashur dhe vlerësuar shqiptari jetën ndër vite, jo vetëm duke mbrojtur shtëpinë, familjen e kombin nga hordhitë armike, por duke mbrojtur edhe gjuhën, zakonet, vlerat dhe kulturën kombëtare si themele të identitetit dhe ekzistencës sonë. Veprimtari të tilla kulturore e përforcojnë edhe më tej këtë bindje, pasi janë tregues domethënës që pavarësisht ndikimeve kulturore e sociale nga të cilat nuk mund të shmanget askush, dimë ende të ruajmë më të mirën tonë, atë që na bënë të ndihemi krenarë që jemi shqiptarë në çdo kënd të globit.

Shoqëria Albsig Jetë, ndihet gjithashtu krenare që u bë pjesë e kësaj nisme kaq të bukur dhe kuptimplotë që ka si qëllim mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, duke qenë dhe vetë një shoqëri që mbron jetën e çdo shqiptari dhe që falë besimit e ndërgjegjësimit të tyre është rritur me hapa të vendosur e do të vazhdojë të rritet përkrah shoqërisë sonë që di si të ruajë atë çka ka më të shtrenjtë.

## 5. Politikat e monitorimit, administrimit dhe kontrollit të riskut të shoqërisë

### 5.1 Kuadri i Administrimit të Riskut


Shoqëria Albsig Jetë Sh.a. mbikëqyret dhe kontrollohet nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve dhe Këshilli Mbikëqyrës. Kompetencat e këtyre organeve drejtuese përcaktohen në Statutin e Shoqërisë dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore.

Albsig Jetë sh.a, ka vendosur objektiva të qarta për periudhën 1-vjecare dhe 3-vjecare dhe rritja e sigurisë për arritjen e tyre kërkon menaxhimin e realizimit të objektivave. Kjo kërkon vendosjen dhe zotërimin e një metode të koordinuar dhe të planifikuar ndaj menaxhimit të riskut, identifikimit, analizimit dhe reagimit ndaj risqeve me të cilat përballet shoqëria. Këtu merr kuptim Politika e Menaxhimit të Riskut e cila kërkon që të shqyrtohet jo vetëm natyra e risqeve, por dhe kuptimi i koncepteve kryesore të menaxhimit të riskut.

Çdo njësi e qeverisjes duhet të përgatisë dhe të miratojë një strategji të menaxhimit të riskut, e cila duhet të përditësohet rregullisht (të paktën një herë në vit) si dhe sa herë kur mjedisi i riskut pëson ndryshime të rëndësishme.

Për të menaxhuar riskun, duhet bërë menaxhimi i proceseve eventualisht në strukturat përkatëse. Risku është pasiguria e rezultatit dhe një menaxhim i mirë i riskut lejon:

- Të rritet besimin në arritjen e rezultateve të dëshiruara



Menaxhimi i mirë i riskut u lejon grupeve të interesit të rrisin besimin në qeverisjen e shoqërisë dhe aftësinë ofruese të saj.

Është e rëndësishme që të gjitha palët e lidhura të kuptojnë rolet e tyre, përgjegjësitë dhe llogaridhënien; duke përfshirë edhe atë që pritet prej tyre dhe autoritetit për vendimmarrje në raportimin.

## 5.2 Menaxhimi i riskut, strategjia dhe politikat e menaxhimit të riskut

### Sistemi i menaxhimit të riskut:

- Përbëhet nga strategji, procese dhe procedura raportimi të nevojshme për të identifikuar, matur, menaxhuar dhe raportuar në mënyrë të vazhdueshme risqet, në një individ dhe në një nivel të agreguar, të cilat janë ose mund të jenë të ekspozuar, si dhe ndërvarësitë e tyre;

- Integrohet në strukturën organizative dhe në proceset e vendimit

Shoqëria Albsig Jetë sh.a. në muajin Dhjetor 2021 në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës miratoi projektplanet për vitin 2022. Këto plane ndihmojnë në ecurinë e shoqërisë dhe në ndërtimet e standarteve për shoqërinë Albsig Jetë sh.a.

Në planin e Biznesit për vitin 2022 u përcaktua dhe ambicja e shoqërisë Albsig sh.a., për arritjet e pritshme për tu realizuar për vitin 2022.

Referuar këtij plani u përpilua dhe plani i menaxhimit të riskut për vitin 2022.

Plani përfshin objektivat përkatëse, parimet kryesore dhe shpërndarjen e duhur të përgjegjësive për të trajtuar riskun në të gjithë veprimtarinë dhe njësitë organizative të shoqërisë së sigurimit, përfshirë edhe degët e saj.

U përcaktua niveli i pranueshëm i riskut, i përcaktuar qartë dhe i miratuar nga Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrjes, duke u këshilluar me drejtuesit e lartë ekzekutivë.

U përcaktuan objektivat që duhet të zbatohen dhe ndiqen nga gjithë njësitë përbërëse të shoqërisë Albsig Jetë sh.a. Këto objektiva janë të vendosura në planin ekonomik financiar si më poshtë:

- Synimi për të qenë shoqëri lider në treg për cilësinë e shërbimit ndaj klientëve;
- Shërbime cilësore dhe në kohë për klientët individë dhe bizneset nëpërmjet ofrimit të produkteve cilësore të sigurimit ekzistuese dhe të reja dhe pagesa shumë e shpejtë e dëmeve;
- Ruajtja e standarteve të larta në përzgjedhjen e personelit që merret me marrjen në sigurim, shitjen dhe e ndërmjetësive në sigurime;
- Nxjerrja në treg e disa produkteve dhe shërbimeve tërësisht të reja për tregun shqiptar të sigurimeve të jetës sipas praktikave më të mira europiane në bashkëpunim me partnerët risigurues;
- Mbajtja e një minimumi të raportit të aftësisë paguese ndaj nivelit minimal të kërkuar prej 250% për të krijuar aftësi absorbuese ndaj luhatjes së rezultatve;
- Synimi për mbajtjen e ROE minimum 10% ndaj kapitalit të vlerësuar sipas SNRF.
- Forcimi i kuadrit të administrimit të risqeve;
- Rritja e volumit të primeve të shkruara bruto me 50%;
- Pagesa shumë e shpejtë e dëmeve;
- Arritja e një pozicioni të qëndrueshëm në tregun e sigurimeve të jetës.
- Përmirësimi i imazhit dhe standarteve

## 5.3 Identifikimi dhe kategorizimi i risqeve

Identifikimi i fushave të riskut, vlerësimi i riskut dhe më tej eliminimi, apo reduktimi i riskut në një nivel të pranueshëm duke kufizuar kostot financiare në minimumin e domosdoshëm.

Menaxhimi i riskut lidhet me risqet dhe mundësitë që ndikojnë në krijimin e vlerave ose ruajtjen e vlerave të përcaktuara si më poshtë:

Në Planin e menaxhimit të riskut identifikimi i risqeve është komponenti kryesor dhe ka për qëllim identifikim e të gjitha risqeve të rëndësishme me të cilat përballet shoqëria.

Shoqëria fokusohet tek risqet kryesore, të cilat pengojnë arritjen e objektivave strategjike. Këto risqe janë pjesë e procesit të administrimit të riskut.

Pjesë e procesit të administrimit të riskut janë dhe risqet që lidhen me veprimtarinë e përditshme.

Shoqëria ka identifikuar si risqe kryesore ku dhe ka orientuar skenarët e stresit si më poshtë:

* Grupi nr. 1	Risku i sigurimit
* Grupi nr. 2	Risku i kreditit
* Grupi nr. 3	Risku i tregut
* Grupi nr. 4	Risku i likuiditetit
* Grupi nr. 5	Risku operacional
* Grupi nr. 6	Risku Ligjor
* Grupi nr. 7	Risku strategjik

Këto janë risqet kryesore që mund të kërcënojnë objektivat strategjike të shoqërisë, por ka dhe risqe të tjera si:

- Risku i këmbimit të monedhës së huaj
- Risku reputacional

### 5.3.1 Risku i sigurimit

Kontrata nën të cilat Shoqëria Albsig Jetë sh.a. pranon të marrë një risk të rëndësishëm nga një palë tjetër (policë-mbajtësi), duke rënë dakord të kompensojë policë-mbajtësin për një ngjarje të caktuar të pasigurtë (ngjarja siguroese) e cila ka efekte negative dhe ndikon në policë-mbajtësin, janë klasifikuar si kontrata sigurimi. Risku nga kontratat e sigurimit është mundësia që ngjarja e siguruar ndodh dhe pasiguria për shumën e dëmit. Për vetë natyrën e kontratave të sigurimit, ky risk është i zakonshëm dhe i paparashikueshëm. Shoqëria është e ekspozuar ndaj pasigurisë së kohës, frekuencës dhe ashpërsisë së dëmeve nën këto kontrata.

Ka risqe që mund ta impaktojnë në afatgjatë portofolin e shoqërisë, sikundër ka edhe risqe që e impaktojnë portofolin në afatshkurtër.

Procesi i marrjes në sigurim në shoqërinë Albsig Jetë kryhet nga ana e Departamenti i Marrjes në Sigurim dhe Marketingut i cili përmban në strukturën e tij Drejtorinë e Sigurimit të Shëndetit dhe Aksidenteve dhe Drejtoria e Sigurimit të Jetës me afat - funksioni kryesor i të cilave është identifikimi dhe vlerësimi i riskut mjekësor si dhe risqeve të tjera si riskut të profesionit, rezidencës, riskut i aktivitetit të kohës së lirë si dhe riskut financiar

Tërësia e procesit të marrjes në sigurim ka të bëjë me "identifikimin e riskut", "analizimin e riskut", "vlerësimin e riskut" dhe "trajtimin e riskut".

Për të realizuar në mënyrë sa me adekuate procesin e vlerësimit të riskut dhe përthithjen e risqeve në përputhje me strategjinë dhe kufijtë e mbajtjes së shoqërisë, shoqëria ka pjesë të strukturës së saj njësi të dedikuara, të cilat veprojnë në përputhje me udhëzimet e hartuara për këtë qëllim.

### 5.3.2 Risku i Kreditit

Risku i kreditit i referohet riskut të mospagimit të detyrimeve kontraktuale të cilat rezultojnë në humbje financiare të shoqërisë. Në rrjedhën normale të aktivitetit të saj, kur pranohen primet fondet investohen për të paguar detyrimet e ardhshme ndaj të siguruarve.

Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut nga fondet e mbajtura, depozitat dhe risiguruesit. Shoqëria ka vendosur procedura të brendshme nga ku risiguruesit mund të kenë klasifikime BB ose norma më të larta dhe risku është i monitoruar nga personeli i risigurimeve. Shoqëria administron ekspozimin e saj ndaj riskut të kredisë duke monitoruar zbulimin ndaj instrumenteve të borxhit dhe depozitave

### 5.3.3 Risku i Tregut

Risku i tregut për shoqërinë lidhet kryesisht me faktorë të tregut financiar, si normat e interesit dhe kurset e këmbimit, apo faktorë të jashtëm, si ecuria ekonomike, si dhe humbje nga portofoli i investimeve



### 5.3.4 Risku i normës së interesit

Risku i normave të interesit është i ndikuar nga risku i luhatjeve të vlerave të instrumenteve financiare si pasojë e ndryshimeve në tregun e normave të interesit dhe risku që maturitetet e interesave në lidhje me aktivet të ndryshojë nga maturiteti i interesave të lidhura me detyrimet e përdorura për këto aktive. Kohëzgjatja për të cilën është fiksuar norma e interesit mbi një instrument financiar tregon se ndaj çfarë niveli risku të normave të interesit është ekspozuar. Aktivet dhe pasivet e shoqërisë kanë norma interesi të tregut. Shoqëria mban një shumë jo të konsiderueshme të detyrimeve interes mbartëse dhe risku i shkakimit të kostove të rëndësishme që vijnë si shkak i rritjes në normat e interesit nuk është domethënës. Në krahasim tjetër, aktivet interes mbartëse kanë normë interesi fikse.

### 5.3.5 Risku nga kurset e këmbimit

Primet janë shprehur në tre valuta kryesore (LEKË, USD dhe EURO). Flukset monetare nga të ardhurat nga primet janë burimi kryesor i fondeve për depozitat me afat në valutë të huaj. Risku i këmbimit të monedhës së huaj lind nga lëvizjet në kurset e këmbimit të monedhës së huaj. Ekspozimi ndaj këtij risku kryesisht lind gjatë një periudhe në të cilën shoqëria ka një pozicion të hapur si në bilanc dhe jashtë bilancit dhe/ose me kursin aktual ose të ardhshëm të tregut.

**Tabela e mëposhtme paraqet një analizë sasiore të rrezikut valutor të shoqërisë më 31 dhjetor 2021 dhe 2020:**

		2021	2020
	Ndikimi	në Lek	në Lek
EUR rritet me 10% ndaj Lekut	Fitim	9,980,051	10,351,732
EUR ulet me 10% ndaj Lekut	Humbje	(9,980,051)	(10,351,732)
USD rritet me 10% ndaj Lekut	Fitim	10,471	617
USD ulet me 10% ndaj Lekut	Humbje	(10,471)	(617)

Tabela 1: Analizë sasiore të riskut valutor të shoqërisë më 31 Dhjetor 2021 dhe 2020.

### 5.3.6 Risku Operacional

Risku operacional lind nga problemet në performancën e funksioneve ose proceseve të biznesit. Ekspozimi ndaj këtij risku mund të lindë nga mangësitë ose defektet në kontrollet e brendshme ose proceset, defektet në teknologji, gabimet njerëzore ose pandershmëria dhe katastrofat natyrore.

Përdorimi më efikasitet i sistemit të shitjes, administrimit dhe dëmeve ka minimizuar shumë risqe duke bërë të mundur një harmonim më të mirë midis kontrollit dhe raportimit.

Rëndësi shumë e madhe i është dhënë pagesës së dëmeve, duke e konsideruar një marketing për shoqërinë. Pagesa e dëmit në një periudhë shumë të shkurtër është një praktikë, e cila ndiqet deri në lajmërimin e klientit që vlera e dëmit të rënë dakord nga klienti ka kaluar në llogarinë e tyre dhe ka ndikuar në performancën e shoqërisë. Shoqëria Albsig Jetë nuk ka dëme në process gjyqësor në 31.12.2021.

Analizat aktuariale ndikojnë në aplikimin e metodave më të mira aktuariale për llogaritjen e provigjoneve të dëmeve (IBNR) dhe për kontrole më të forta mbi të dhënat nga Aktuari, sidomos të dëmeve të Jetës së Debitorit.

Rreziku operacional lind nga problemet në performancën e funksioneve ose proceseve të biznesit. Ekspozimi ndaj këtij risku mund të lindë nga mangësitë ose defektet në kontrollet e brendshme ose proceset, defektet në teknologji, gabimet njerëzore ose pandershmëria dhe katastrofat natyrore. Shoqëria Albsig Jetë sh.a. ka struktura dhe politika të mjaftueshme për menaxhimin e riskut operacional. Njësia e Auditimit të Brendshëm, raporton rregullisht pranë Këshillit Mbikëqyrës për eficiencën dhe efektivitetin e këtyre politikave dhe strukturave në menaxhimin e riskut operacional.

### 5.3.7 Menaxhimi i katastrofave

Menaxhimi i katastrofave dhe rikthimi në gjendje normale pas katastrofave, në shoqërinë Albsig Jetë sh.a. merr në konsideratë marrjen e masave të nevojshme për të mundësuar vazhdimësinë e funksioneve jetike të biznesit, në mënyrë specifike:

- Klasifikimi i:

- a) Sistemeve informatike,
- b) Të dhënave informatike,

- Plani i veprimeve për t'u ndërmarrë,
- Personat përgjegjës,
- Shërbimet publike përgjegjëse,
- Vendndodhjet në dispozicion,
- Situatave të adaptueshmërisë në periudha post ngjarje,
- Testimet e procesit, si dhe
- Trajnimi dhe vënia në dijeni e të gjithë stafit të Albsig Jetë sh.a.

Të gjitha kontaktet e nevojshme për të bashkërenduar komunikimin (numra telefoni, email, adresa) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme. Ambientet Albsig Jetë sh.a janë të pajisur me fikse zjarri, të cilat mirëmbahen periodikisht. I gjithë personeli i Albsig Jetë sh.a. është trajnuar për përdorimin tyre. Të gjitha ambientet e Albsig Jetë sh.a plotësojnë të gjitha masat e Mbrojtjes Kundra Zjarrit (MKZ) sipas ligjit Nr. 152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin" të Republikës së Shqipërisë.

### 5.3.8 Siguria e sistemeve kompjuterike

Ambienti i Disaster Recovery mundëson hapësirat e nevojshme të veprimtarisë së bizneseve kyçe gjatë eventeve kur zyrat qendrore janë të padisponueshme. Gjithashtu është siguruar një ambient i izoluar fizikisht ku instalohen pajisjet IT që ofrojnë vijueshmërinë e sistemeve IT.

### 5.3.9 Risku i Likuiditetit

Norma e likuiditetit është raporti midis aktiveve likuide të shoqërisë dhe detyrimeve të maturuara për pagesë si dhe detyrimeve që maturohen së shpejti.

Shoqëria e sigurimit konsiderohet likuide në qoftë se rezultati i llogaritjes së normës së likuiditetit, referuar në nenin 6 të rregullores "Mbi administrimin e likuiditetit nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit", është më i lartë ose i barabartë me 1 (një).

Për qëllim të monitorimit të likuiditetit shoqëria bën monitorimin e fluksit të parasë në mënyrë periodike duke u bazuar në llogaritjet me bazë ditore të normës së likuiditetit dhe është më i lartë se 1 (një).

### 5.3.10 Risku Ligjor dhe Rregullator

Shoqëria realizon veprimtarinë e saj sipas legjislacionit në fuqi. Forma e saj e organizimit tregtar për të ushtruar të tilla aktivitetet tregtar është ajo e sanksionuar me ligj, pra shoqëri aksionare. Sistemi i organizimit të shoqërisë është me dy nivele, pra me Këshill Mbikëqyrës (niveli më i lartë ekzekutiv) si dhe Asambleja Aksionare. Detyrat funksionale të Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë si menaxheri më i lartë i administrimit të nivelit të parë të shoqërisë dhe raportimi në sistem vertikal rregullohen nga akti me i rëndësishëm i shoqërisë që është Statuti i shoqërisë.

Po ashtu detyrat e përgjithshme për auditim të pavarur të pasqyrave financiare, nga auditues të jashtëm që plotësojnë kriteret e legjislacionit në tërësi, përcaktohen në aktin më të rëndësishëm të shoqërisë në Statut. Gjithashtu edhe kërkesat për të pasur pavarësi në kontroll dhe raportim të auditit të brendshëm si një njësi e mirë përcaktuar me detyra funksionale po aq mirë të përcaktuara.

## 5.4 Rezultatet e marrjes në sigurim për vitin 2021

Duke u bazuar testi i rezultateve të marrjes në sigurim sipas produkteve dhe portofoleve si më poshtë për vitin 2021:

**Produkti i Jetës së debitorit** ka raporti dëme/prime neto nga 27 % për arsye të dëmëve si rrjedhojë e pandemisë. Konstatohet se ka raport të lartë i shpenzimeve, jashtë diapazonit normal.

Ky raport do të vazhdojë të monitorohet me kujdes në të gjitha elementet përbërëse të tij nga menaxherët e marrjes në sigurim të këtij portofoli që të jetë në normat e duhura.

**Produkti Sigurimi I Jetës në grup.** Konstatohet se ka raport tepër i lartë i shpenzimeve, jashtë diapazonit normal, si rrjedhojë e shpenzimeve administrative.

Ky raport do të vazhdojë të monitorohet me kujdes në të gjitha elementet përbërëse të tij nga menaxherët e marrjes në sigurim të këtij portofoli që të jetë në normat e duhura.

**Sigurimi sipas skemave 'cash plan'** Konstatohet se ka raport të lartë i shpenzimeve, jashtë diapazonit normal, si rrjedhojë e shpenzimeve administrative.

Ky raport do të vazhdojë të monitorohet me kujdes në të gjitha elementet përbërëse të tij nga menaxherët e marrjes në sigurim të këtij portofoli që të jetë në normat e duhura.

**Raporti i kombinuar në total është ruajtur 82.20% nga 92.36% në vitin 2020.**

## 5.5 Risku Ligjor dhe Rregullator

Toleranca ndaj riskut përcaktohet nga objektivat strategjike të shoqërisë. Objektivat strategjike të shoqërisë janë të lidhura kryesisht me objektivat e rritjes në treg, marzhet e synuara të fitimit dhe mbajtjen e një niveli kapitali mbi një marzh të caktuar. Në këto objektiva është përcaktuar si qëllimi i pozicionimit në treg në pjesmarrje, ashtu dhe në raport me cilësinë e shërbimit.

Matësit e nivelit të riskut që përdoren kryesisht janë kufijtë gjatë procesit të marrjes në sigurim, si për ekspozimet individuale ashtu dhe për ekspozimet agregate sipas linjave të sigurimit.

Shoqëria ka manual dhe procedura të hartuara për këtë qëllim.

Shoqëria zbaton marrëveshje risigurimi treaty, fakultative në mbrojtje të kapitalit.

### 5.5.1 Kufijtë për risigurim

Shoqëria Albsig Jetë Sh.a ka politika të risigurimit që kanë për qëllim përcaktimin e kriterëve dhe metodikën mbi bazën e të cilave lidhen programet e marrëveshjeve të risigurimit në mënyrë që aktiviteti sigures i shoqërisë të veprojë në një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent, në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të biznesit nga risqe të ndryshme, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Shoqëria Albsig Jetë Sh.a risiguron të gjitha risqet apo pjesë të përgjegjësive që ka kontraktuar me të siguruarit që tejkalojnë mbulimin maksimal të shoqërisë, të masës 10% të Aftësisë Paguese të shoqërisë Albsig Sh.a.

Marrëveshjet e risigurimit janë nënshkruar vetëm me shoqëritë e risigurimit që përmbushin kushtet sipas Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

## 5.6 Administrimi i kapitalit dhe Niveli i Aftësisë Paguese

Shoqëria ka objektiv kryesor që niveli i kapitalit që do mbajë do të jetë sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Shoqëria do ruajë një nivel marzhi 250% ndaj kufirit minimal të kërkuar të kapitalit, sipas metodës me bazë primet ose dëmet, si dhe do synojë gradualisht dhe mbajtjen e një niveli të paktën 150% të fondit të garancisë.

